

Raporti i dhjetë tremujor (Drafti)

Tetor 2013 - janar 2014.



Program finansira EU



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



 UNOPS

Sprovodi program

euprogres 

Program evropskog partnerstva sa opštinama

Përmbledhje

Përparimi drejt përfundimit të programit është stabil: 223 nga 262 projekte të kontraktuara respektivisht 85% të projekteve janë mbyllur, dhe nuk ka projekte kritike. Mjetet e përgjithshme të shpenzuara në program nga fundi i janarit të vitit 2014 përbëjnë shumën prej 94,53% të buxhetit. Sufinancimi i kontraktuar ka arritur shumën prej 3,3 milion euro, përderisa të hyrat jo-monetare të shënuara kanë arritur shumën prej rreth 25 milion euro.

Më shumë të dhëna tregojnë për faktin se programi do të ketë ndikim të rëndësishëm në zhvillim ekonomik dhe punësim. Janë anagazhuar rreth 120 persona në objektin e përkohshëm të fabrikës *Geox*, përderisa punimet tokësore në parcelën e dedikuar për ndërtim është në vazhdim e sipër. Edhe pse nevojitet që Zona e gjelbërt në Leskoc të përparojë më shpejtë, Këshilli komunal ka aprovuar kornizën e aktiviteteve të cilat mund të bëjnë zonën funksionale, janë përgatitur kushtet për huazimin e tokës kurse kompanitë janë ftuar publikisht që të investojnë në zonë.

Përparim i madh është realizuar në kuadër të aktiviteteve të reja në fushën e barazisë gjinore të cilën e financon qeveria e Zvicrës në shumë prej 402.850 euro. Posaçërisht, projektin më të rëndësishëm paraqet sigurimi i pajisjes për maternitetin në Preshevë, në shumë prej 255.000 evra. Ky intervenim është në top listën e prioriteteve të Qeverisë së Republikës së Serbisë për jugun e vendit, kurse ka krijuar kushte për hapjen e sërishme të maternitetit pas 24 vjetëve. Parashikohet se rreth 400 gra nga Presheva dhe rrethina në vit do të lindin këtu në vend se të udhëtojnë në qytete të afërta.

Kanë përfunduar disa aktivitete: Fondi për pjesëmarrjen qytetare, infrastruktura lokale, dokumentacioni teknik, buxhetimi i programuar, çertifikimi për sistemin e menaxhimit të kualitetit, si dhe kampanjat për ngritjen e vetëdijes së qytetarëve. Projektet për përkrahjen e grupeve të rrezikuara kanë treguar rezultate të mira. Ka përfunduar ndërtimi i rrjetit të ujës-jellësit në Jellashnicë (Surdulicë) ka mundur qasje në ujë të pijshëm për 1.670 qytetar, prej të cilëve 400 Romë. Në Novi Pazar iu është dorëzuar vetura kombi Qendrës regionale për qëndrim ditë dhe angazhim për punë të personave me vështirësi intelektuale, që do të përdoren për transportin e 60 shfrytëzuesve të qendrës.

Pas katër vizitave në nivel të lartë gjatë katër muajve, duke përfshirë tri vizita të ambasadorit të Delegacionit të Unionit evropian në Serbi, 27 deklaratë për shtyp dhe 445 raporte të mediave, është e qartë se mesazhet zhvillimore të cilat i dërgon programi kanë arritur te publiku i cili është shumë më i madh se sa shfrytëzuesit direkt në jug dhe jugperëndim të Serbisë.

Zgjedhjet parlamentare të cilat do të mbahen më 16 mars mund të paraqesin pengesë me rastin e mbylljes së aktiviteteve të programit, duke pasur parasysh se nevojitet përkrahja e komunave deri në ditën e fundit për shkak të vizitave përfundimtare të revizorëve, grumbullimit të dokumentacionit komunal i cili mungon dhe i cili do të shërbejë si burim për revidimin e punës, të takimeve të fundit të evaluimit, kthimit të parave të tepruara, dorëzimit të pajisjeve, etj. Përkundër kësaj, programi ka vendosur që me kohë të përfundojë

aktivitetet dhe të krijojë bazë shumë më të fortë se sa para katër vjetëve për zhvillim më të shpejtë të Serbisë jugore dhe jugperëndimore.

DRAFT